

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 30 QERSHOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Pa diskutim, sot po pranohet realiteti, pavarësisht se për arsye propagandistike nga ana e qeverisë, ku fjala krizë, që ne e përmendim dhe përmendet në çdo seancë, po përmendet sot nga qeveria thuajse në çdo fjalim dhe nga përfaqësuesit e kësaj majorance në parlament vetëm për të justifikuar që më shumë sesa interesi që kanë për qytetarët, kanë interes dhe prioritet të ndihmojnë një grusht oligarkësh dhe njerëzish, me të cilët, duhet thënë qartë, shkoqur, pastër, e kanë shqyer Shqipërinë dhe e ndajnë buxhetin e shtetit në mënyrë të përvitshme, duke u dhënë llokma të mëdha të parave publike.

Nuk ka diskutim që, nëse do të ishim në kushtet ku u është dhënë ndihmë të gjithë kategorive të tjera, ndihmë reale, do t'u vinte radha edhe kompanive më të privileguara në këtë vend, atyre që njihen si kompanitë që marrin tenderë, marrin dhe japin tenderë me qeverinë. Qytetarët e dinë mirë se për cilat kompani bëhet fjalë, opinionin publik e di mirë se ç'do të thotë të ndash tenderë me qeverinë dhe se si i ndajnë këto punë. Pa diskutim që është çështje prioriteti dhe këtu ndahemi ne, te prioritetet. A duhet të ndihmoheshin kompanitë, të cilat, ju thonin janë 300 kontrata, por po t'i shohësh janë thuajse gjithsej 50 veta në të gjithë Shqipërinë, që marrin punët publike, sa me një kompani, me një kompani tjetër, me variante sikur marrin letra dhe dokumente nga një kompani tjetër, për t'u dukur sikur janë të ndryshme?

Në fakt, janë të njëjtët oligarkë, që marrin para nga taksat e qytetarëve dhe nga paratë publike dhe i kthejnë kulla në Tiranë, duke parë spektaklin e shëmtuar të ndërtimit në çdo cep të Tiranës. E shikoni që një pjesë e madhe e tyre janë edhe ata që doni të ndihmoni për të pastruar para, me një nismë tjetër që keni filluar, që është nisma për amnistinë e të gjithë kësaj kategorie. Tani, në këtë situatë ku jemi, a jemi ne koshientë, qytetarët po e po, por thjesht t'ju

rikthehemi edhe juve si qeveri, që duhet të penalizoheshin këto kompani, të cilat në shumicën e punëve publike nuk i kanë kryer punët në afat? Kjo është një pyetje që e bën kushdo. Në vend të penalizohen, këto kompani favorizohen, duke u dhënë para shtesë.

Në qarkun e Korçës ka 9 vjet rruga Kukës-Qafë Pllaçë, ka po 9 vjet rruga e Ersekës, pra nuk kryhen punimet. E njëjta gjë me Rrugën e Dibrës, e njëjta gjë me çfarëdolloj rruge dhe pune tjetër publike në këtë vend. Në këtë situatë, në vend të penalizohen, këto kompani vazhdojnë të marrin më shumë para. Për të kuptuar se cili është realiteti dhe shqetësimi që ka kjo qeveri si në rastin e këtyre kompanive, shikoni se për çfarë bëhet diskutimi në publik këtë javë! Është hapur një diskutim i madh publik ndërmjet Kryeministrit, ministres dhe deputetëve të Partisë Socialiste për numrin e lopëve, se u kanë humbur lopët! Këtu kanë ikur 500 mijë njerëz, kanë kërkuar azil dhe këta bëjnë sikur nuk e shohin këtë, por shqetësimi më i madh qenka se ka rënë numri i lopëve dhe numërojnë lopët nëse kanë rënë apo jo me 50 mijë, ndërkohë që për fermerët nuk ka asnjë ndihmë!

400 lekë të vjetër shitet sot kilogrami i qershive në të gjithë qarkun e Korçës, 400 lekë të vjetër për kilogramë kërkon sot një punëtor për t'i vjelë! Imagjinoni se si dalin ata me kostot e tjera të prodhimit! Këtu duhet të ndërhyjë qeveria dhe duhet ta ketë prioritet këtë. Çmimi për një kilogram qershie në Tiranë është minimalisht 2000 lekë të vjetër. Pra, nuk fiton ai që e prodhon, mbase nuk fiton as ky tjetri që shet këtu, fitojnë vetëm transportuesit dhe oligarkët që ju keni krijuar, që janë pjesë e kësaj liste, që monopolizojnë tregjet, që kanë mundësi të monopolizojnë edhe aty dhe të shkojnë t'ua marrin me atë çmim ose ndryshe janë të detyruar t'i hedhin. Çfarë prioritetesh ka qeveria?! Dëgjova pak më parë përfaqësuesit e qeverisë, që thanë se gruri ka qenë i mbarë, të korrat kanë ecur mirë dhe misri është rritur pak më shumë.

Ku hyn qeveria këtu?! Ç'punë ka qeveria me këto?! Sa para ka dhënë qeveria për të ndihmuar fermerët në mënyrë të drejtpërdrejtë? Si ka shkuar çmimi i pesticideve? Si ka shkuar çmimi i plehrave kimike? Po farërat? Po çmimi i naftës, që ka shkuar në stratosferë dhe naftën që ndan qeveria e marrin vetëm njerëzit të cilët kanë lidhje me qeverinë dhe me Partinë Socialiste? Për çfarë po diskutojmë ne? Për prioritetet po diskutojmë, ngaqë ato janë vetëm për një grusht oligarkësh dhe diskutimet në publik janë: "U dha Butrinti". Pallati i Brigadave u dha sot në

media. Do ta japin edhe Pallatin e Brigadave. Tritol nga ana tjetër! Mbrëmë iu vu tritol hotelit të një drejtori në Sarandë, parmbrëmë iu vu tritol makinës së një drejtoreshë në Shkodër.

Çfarë autoriteti ka shteti këtu?! Ose janë njerëz të lidhur me krimin dhe janë futur aty si persona problematikë dhe u ndodhin këto, ose autoriteti i shtetit është në fund të këmbëve dhe merret nëpër këmbë nga çdo lloj banditi. E shtata në botë është Shqipëria (rekord i zi) për drogën, për kanabisin; “Rrugë kalimi për heroinën”, thuhej në raportin e OKB-ës; rrugë transiti për kokainën dhe grupet e strukturuar kriminale e grupet e krimit të organizuar kontrollojnë të gjithë Shqipërinë! Pse ndodhin këto? Ngaqë ka shtet apo ngaqë ka shtet prej pambuku, apo ngaqë shteti është i interesuar vetëm për një grusht oligarkësh, që i nisin rrugët me 50 milionë dhe shkojnë 180 milionë, që i nisin me 70 milionë dhe i përfundojnë me 500 milionë?

Prandaj është e pamundur, jo se nuk ka para Shqipëria, por sepse paratë, të cilat nuk i jepni ju nga xhepi, nuk i jep as qeveria nga xhepi, por ka marrë nëpërmjet rritjes së çmimeve shumë më shumë të ardhura, duke ua zhvatur qytetarëve nga xhepat e tyre, nuk i ka shpërndarë në mënyrë të drejtë, nuk ndihmon shtresat në nevojë, as pensionistët, për të cilët flisni, as familjet në nevojë, as bizneset e ndershme. Nëse do të kishte një favorizim, ku do të prekeshin punëtorët, ku do të prekej edhe biznesi i ndershëm dhe do të nisej nga ata, pa diskutim që ne do të votonim pro. Por çfarë të votosh? Të votosh që më të pasurve në këtë vend, që janë bërë të tillë jo në bazë të meritës dhe të punës, por në kurriz të dhjetëra, mijëra e qindra qytetarëve të tjerë, vetëm se kanë lidhje me qeverinë t’u jepen edhe ca para të tjera, që të majmen edhe më shumë?

Çfarë politike është kjo?! E majtë jo e jo, por kjo është totalisht politike zhvatjeje hapur me ligj dhe është hapur klienteliste. Pa pikë turpi bëhet sikur po ndihmohet ekonomia, se po marrin lekë 30-40 veta, ndërkohë që të gjithë të tjerët nuk përballojnë dot as çmimin e naftës, as çmimin e ushqimeve dhe asnjë gjë tjetër! Çfarë ndodh me këto para? Një pjese të madhe po u bëjnë pastrim po këto kompani në Tiranë. Dalin e mburren kryetari i bashkisë dhe Kryeministri! Indeksi i Bazelit thoshte që 1,6 miliardë euro pastrohen në Shqipëri vetëm në ndërtim, një sektor ku bankat nuk japin para, për shkak se e shohin si sektor me risk, ndërkohë që ndërtimet vazhdojnë dhe rriten e burimi i parave nuk dihet nga vjen. Çfarë është bërë në këto kohë krize,

por edhe para krizës nga ana e Partisë Socialiste, përveçse paratë që merrnit, ua merrni edhe më shumë njerëzve?!

Kategorive të tjera jo në nevojë, që i japin Shqipërisë nëpërmjet punës së tyre intelektuale në sektorët e lirë ku punojnë, kërkoni t'u rrisni taksat. Paratë që sot po ia jepni një grushti oligarkësh do të mjaftonin që të paktën të mos propozonit që të gjithë avokatëve, noterëve apo atyre që punojnë në profesionet e lira t'u rriteshin taksat. Prandaj, ngaqë nuk ka prioritete, ngaqë kjo qeveri nuk ka interes për qytetarët, ndodhë përditë të ketë përfshirje të personave të lidhur me krimin e organizuar dhe të vendosjes së shtetit në shërbim të tyre, sepse ju i merrni votat me këta dhe i ndani paratë me këta.

Ja ku e keni këtë tjetrën sot në Elbasan: dy zëvendësdirjtorë policie, njëri prej të cilëve u thoshte mediave sot të mos e shqetësonin, pasi ka manipuluar ngjarjen dhe ka prodhuar vrasje aty! Janë të njëjtët njerëz që manipulojnë ngjarjet për interesin e Partisë Socialiste, për interesin e qeverisë, sa herë ndodhin skandale në këtë vend dhe sa herë denoncohen skandale e kapen me presh në duar. Për shkak se është një qeveri që i shërben vetëm një grushti njerëzish dhe tenton ta mbajë me forcë këtë vend, ka përfunduar kështu situata e qytetarëve shqiptarë, por dita po vjen!